



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

### RAPORTI VJETOR I TRANSPARENCËS NË PROCESIN E VENDIM-MARRJES PËR VITIN 2020

#### **1. Përmbledhja ekzekutive**

Gjatë vitit 2020, në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 837, datë 4.12.2020, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020", i ndryshuar me VKM nr. 150, date 19.2.2020<sup>1</sup>, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka planifikuar miratimin e 5(pesë) projektligjeve.

Gjatë vitit 2020, MBZHR ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit. Numri i përgjithshëm i projekt-akteve për të cilët është planifikuar konsultim gjatë vitit 2020 është 6 (gjashtë) dhe ka realizuar procesin e konsultimit publik për të gjitha këto projekt-akte.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për vitin 2020 ka patur një numër vizitorësh në rritje nga publiku, duke patur një numër prej 2174 vizitorësh në total për të gjithë projektaktet për të cilat është zhvilluar konsultimi publik. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të publikut dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

#### **2. Analiza e konsultimeve të kryera**

##### ***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

###### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Numri i përgjithshëm i akteve të planifikuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për konsultim publik gjatë vitit 2020 është 6 (gjashtë) projektligje, si vijon:

<sup>1</sup>Shih në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/837>

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve".
2. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 64/2012 date 31.05.2012,"Për peshkimin" i ndryshuar.
3. Projektligji "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit"
4. Projektligji "Për Vreshtarinë dhe Verën"
5. Projektligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", i ndryshuar.
6. Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar"

Të 6 (gjashtë) projektaktet e planifikuara për konsultim publik janë projektligje. 5 (pesë) projektligjet janë të përfshira në PPAP, ndërsa 1(një) projektligj nuk është përfshirë në PPAP e vitit 2020. Në PPAP e vitit 2020 kanë qenë parashikuar gjithsej 35 projektakte për t'u miratuar gjatë vitit 2020 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pra, MBZHR ka planifikuar për konsultim 14% të akteve të PPAP, kjo në përputhje me detyrimet për konsultim në kuadër të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t'iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur.

#### *2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*


Të 6 (gjashtë) projektaktet e planifikuara për konsultim publik i janë nënshtruar konsultimit publik, si dhe 1 (një) projektligj nuk është përfshirë në PPAP e vitit 2020. Pra, nga aktet e planifikuara për t'u konsultuar gjatë vitit 2020, janë konsultuar 100% e tyre.

#### *2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

4 (katër) nga 6 (gjashtë) projektligjet e konsultuara në RENJK kanë pasur edhe raporte VNR. Projektligjet e publikuara në RENJK me VNR janë:

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve".
2. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 64/2012 date 31.05.2012,"Për peshkimin" i ndryshuar.

3. Projektligji “Për Vreshtarinë dhe Verën”
4. Projektligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, i ndryshuar.





Për dy projektligjet e tjerë VNR është përgatitur, por nuk është hedhur në RENJK.


*2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Nuk kemi asnjë rast të mos konsultimit të projektakteve të planifikuara për konsultim.

Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të ligjit të lartpërmendur.

	Projekt të parashikuara	Projektakte të publikuara për konsultim	Projektakte jo të publikuara për konsultim	% e akteve të publikuara për konsultim
a) PPAP	35	6	29	17%
b) PKIE	9	1	8	11%
c) Dokumente strategjik të sektorit	-	-	-	-





2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Të gjitha aktet e konsultuara kanë qenë projektligje.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Gjatë vitit 2020 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezultoi me një shkallë realizimi të procesit të konsultimit publik 100%. Jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me vitin apo edhe vitet e mëparshme. Të dhënat e përfutuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë në rritje, pavarësisht faktit se nuk janë përcjellë komentet përmes këtij portal, por nëpërmjet emailëve në adresën e koordinatorit të konsultimit publik. Gjatë vitit 2020 vihet re një interes në rritje i organizatave/shoqatave në drejtim të përmirësimit të projektakteve.

Vlerësojmë se gjatë vitit 2020, një faktor që mund të ketë ndikuar në mungesën e reagimeve nga ana e publikut ka qenë dhe situata e krijuar nga pandemia mbarëbotërore shkaktuar nga COVID-19.

## 2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,

2. tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi/komisione këshillimore/universitete
3. komunikim nëpërmjet postës elektronike.

Të gjithë projektligjet të parashikuara për konsultim iu nënshtruan të tre metodave të konsultimit.

#### **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”**

Forma e konsultimit publikimi për Konsultim Publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Në përfundim të afatit të këtij konsultimi, gjithashtu, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, së bashku me relacion shpjegues i është dërguar me email për komente dhe sugjerime Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve në UBT, shoqatës AFADA, Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencive Rajonale të ekstensionit Bujqësor dhe Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

#### **Projektligji "Për disa ndryshim në ligjin nr. 64/2012 date 31.05.2012,"Për peshkimin" i ndryshuar.**

Forma konsultimit të përzgjedhur është publikimi në RENJK. Procesi i njoftimit dhe publikimit në regjistrin elektronik ka përfunduar dhe nuk ka pasur komente apo rekomandim nga palet e interesuara. Ky projektligj është konsultuar në Komisionin Konsultativ Qendror, “Për peshkimin dhe b Akvakulturën” (KKQPA), të ngritur sipas nenit 21 të ligjit nr.64/2012 “Për peshkimin” i ndryshuar dhe ka marrë miratimin e këtij Komisioni. Gjithashtu, në kuadër të Projektit IPA 2016 (EuropeAid/155184/DD/ACT/AL) është bërë konsultim publik më datë 16/01/2020 në portet e peshkimit Durrës, më datë 21/01/2020 në Vlore, më datë 22/01/2020 në Sarandë dhe në datë 27/01/2020 në Shëngjin diskutimi i ndryshimeve në ligjin e peshkimit, krahas prezantimit të skemës së mbështetjes më grante nga projekti.

#### **Projektligji“Për vreshtarinë dhe verën”**

Format e konsultimit ishte përmes Regjistrin Elektronik, RENJK. Krahas publikimit në këtë regjistër, projektligji, së bashku me relacionin e RIA u dërgua me email grupeve të interesit si dhe u zhvilluan takime në MBZHR. Grupet e interesit të cilëve iu dërgua email dhe u ftuan në takime në MBZHR ishin: Prodhuesit dhe përpunuesit e rrushit për verë, shoqata e prodhuesve të verës familjare, Këshilli Agrobiznesit Shqiptar, Profesorë të Universitetit Bujqësor, akademikë të fushës së vreshtarisë, Shoqata e Sommelierisë Shqiptare, etj.

#### **Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”**

Format e konsultimit ishte përmes Regjistrin Elektronik, RENJK. Krahas publikimit në këtë regjistër, projektligji, projektligji iu dërgua me email grupeve të interesit si dhe u zhvilluan takime publike në Berat dhe Shkodër.

### **Projektligji “Për Kultivimin, grumbullimin, perpunimin, prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe te produkteve te tij”**

Format e konsultimit ishte përmes Regjistrit Elektronik, RENJK. Krahas publikimit në këtë regjistër, projektligji, së bashku me relacionin e RIA u dërgua me email grupeve të interesit si dhe u zhvilluan takime në MBZHR. Gjithashtu hartimi i këtij projektligji është paraprirë nga një e situatës aktuale të kultivimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit, shqyrtimit të legjislacionit në fuqi në fushën e duhanit, njohjen e praktikave më të mira, etj., kryer nga grupi i punës i përbashkët me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë së Tatimeve, Agjencia e Duhan Cigareve, përfaqësues nga shoqatat e fermerëve, industria e duhanit, impurtuesit e duhanit si dhe konsulentë të pavarur.

### **Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”**

Format e konsultimit ishte përmes Regjistrit Elektronik, RENJK. Gjithashtu, me datë 24.11.2019 është zhvilluar një takim konsultativ me të gjitha grupet e interesit. Të pranishëm kanë qënë përfaqësues nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, stacionet veterinare, farmacistë veterinar, fermere, veterinerë zyrtar dhe privat. Janë diskutuar të gjitha ndryshimet e propozuara në projektligji si dhe janë marrë në konsideratë sugjerimet e bëra. Gjithashtu, nën drejtimin e Ministrit të Bujqësisë, janë zhvilluar dy takime me Bordin Strategjik të Ministrisë së Bujqësisë ku janë diskutuar nenet e ndryshuara të propozuara në këtë projektligji dhe struktura e shërbimit veterinar. Konsultime janë zhvilluar edhe me Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes vendore.

#### *2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit/takimeve dhe email – rreth 79 komente, ndërsa nga konsultimi publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nuk kishte asnjë koment.

#### *2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Për disa projektligje janë organizuar konsultime paraprake. Konkretisht për projektligjin “Për Kultivimin, grumbullimin, perpunimin, prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe te produkteve te tij” hartimi i këtij projektligji është paraprirë nga një e situatës aktuale të kultivimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit, shqyrtimit të legjislacionit në fuqi në fushën e duhanit, njohjen e praktikave më të mira, etj., kryer nga grupi i punës i përbashkët me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë së Tatimeve, Agjencia e Duhan Cigareve, përfaqësues nga shoqatat e fermerëve, industria e duhanit, impurtuesit e duhanit si dhe konsulentë të pavarur.

Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” u hartua nga një grup pune ngritur me urdhër të Ministrit për këtë qëllim një përfshirje të të gjithë institucioneve kontribuese: MBZHR, organizatat e shoqërisë civile, si dhe ekspertë ndërkombëtar dhe lokal, të siguruar me mbështetjen e Kooperacionit Italian.

Projektligji “Për vreshtarinë dhe verën” u hartua nga një grup pune ngritur me urdhër të Ministrit për këtë qëllim një përfshirje të të gjithë institucioneve kontribuese: MBZHR, AKU, QTTB Fushë-Krujë, Universiteti Bujqësor.

### **2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve**

*2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Konsultimet në RENJK për të gjitha projektligjet kanë qenë të hapura për 20 ditë, pra u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit, si vijon:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve". U postua më datë 06.04.2020 dhe ka përfunduar më datë 02.05.2020;
2. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 64/2012 date 31.05.2012,"Për peshkimin" i ndryshuar. U postua më datë 22.01.2020 dhe ka përfunduar më 22.02.2020;
3. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”. U postua më datë 29.06.2018 dhe ka përfunduar më 25.07.2018;
4. Projektligji “Për Vreshtarinë dhe Verën”. U postua më datë 30.06.2020 dhe ka përfunduar më 29.07.2020;
5. Projektligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, i ndryshuar. U postua më datë 13.10.2020 dhe ka përfunduar më 09.11.2020;
6. Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”. U postua më datë 08.11.2018 dhe ka përfunduar më 06.12.2018;

**Për projektligjin “Për Vreshtarinë dhe Verën”** - kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 30.6.2020 deri më 30.9.2020. Në këtë afat përfshihen edhe takimet publike me grupet e interesit edhe konsultimi përmes regjistrit elektronik. Procesi i konsultimit përmes regjistrit elektronik në RENJK zgjati nga data 30.6.2020 deri më 29.7.2020. Duke qenëse pati një interes nga grupet e interesit (prodhues, përpunues) afati i konsultimit u zgjat deri në datë 30 shtator 2020. Gjatë kësaj periudhe u realizuan dy takime në MBZHR



(datë 5.10.2020 dhe datë 11.9. 2020) me prodhues, përpunues dhe shoqata të verës, si dhe disa takime online me prodhuesit grupin e punës dhe ekspertin e huaj që asistoi. Gjithashtu u komunikua dhe përmes postës elektronike. Nisur nga kompleksiteti i legjislacionit në këtë fushë, procesi i hartimit dhe konsultimit të projektligjit nga grupi i punës ka zgjatur për rreth një vit. Projektligji është miratuar në Këshillin e Minsitrave dhe pritet të kalojë në Parlament.

**Për projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”** - kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 16.5.2018 deri më 25.7.2018. Në këtë afat përfshihen edhe takimet publike me grupet e interesit edhe konsultimi përmes regjistrimit elektronik. Procesi i konsultimit përmes regjistrimit elektronik në RENJK zgjati nga data 29.6.2018 deri më 25.7.2018. Gjatë kësaj periudhe u realizuan dy takime në Shkodër dhe Berat (respektivisht datë 16.5. 2018 dhe datë 18.5.2018) me pushtetin vendor, Agjencinë e Zhvillimit Rajonal, Dhoma Rajonale e Tregtisë dhe Industrisë, Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, Organizatat e Shoqërisë Civile; Shoqatat e Fermerëve; Shoqatat e Biznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, etj.. Gjithashtu u komunikua dhe përmes postës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit projektligji u dërgua për mendime në ministrinë e linjës. Aktualisht është në fazën e bashkërendimit.

**Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”** - Në datën 24.11.2019 është zhvilluar një takim konsultativ me të gjitha grupet e interesit. Të pranishëm kanë qenë përfaqësues nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, stacionet veterinare, farmacistë veterinar, fermere, veterinare zyrtar dhe privat. Janë diskutuar të gjitha ndryshimet e propozuara në projektligj si dhe janë marrë në konsideratë sugjerimet e bëra. Gjithashtu, nën drejtimin e Ministrit të Bujqësisë, janë zhvilluar dy takime me Bordin Strategjik të Ministrisë së Bujqësisë ku janë diskutuar nenet e ndryshuara të propozuara në këtë projektligj dhe struktura e shërbimit veterinar. Konsultime janë zhvilluar edhe me Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes vendore ku janë diskutuar tranferimi i funksioneve nga njësitë e vetqeverisjes vendore në shërbimin veterinar rajonal.

### *2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 8 (tetë) muaj.

### *2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit përmes RENJK, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët. Mosinformimi dhe mungesa e kulturës së përfshirjes në hartimin e politikave publike ka sjellë edhe mungesën e reagimeve mbi aktet e publikuara për konsultim në RENJK. Megjithatë përmes formave të tjera të konsultimit (takime/postë elektronike) ka patur

përfshirje të lartë sidomos të grupeve të interesit në dhënien e komenteve/sugjerimeve për projektaktet (projektligji për vreshtarinë dhe verën, duhanin, etj.).

Vlerësojmë se gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia mbarëbotërore shkaktuar nga COVID-19, ka patur reagime nga grupet e interesit për projektligjet e publikuara.

#### **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

Në hartimin dhe konsultimin e ligjeve të planifikuara për t'u konsultuar gjatë vitit 2020 kanë marrë pjesë ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqata që operojnë në fushën e bujqësisë, përfaqësues të Universitetit Bujqësor, etj..

##### *2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

Për projektligjin "Për vreshtarinë dhe verën" u hartua nga një grup pune ngritur me urdhër të Ministrit me një përfshirje të të gjithë institucioneve kontribuese: MBZHR, AKU, QTTB Fushë-Krujë, Universiteti Bujqësor si dhe ekspert i huaj.

Në hartimin e projektligjit "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit", në grupin e punës të ngritur për këtë qëllim kanë marrë pjesë 5 ekspertë të jashtëm, nga shoqata të ndryshme dhe Cooperazioni Italian.

Gjithashtu, edhe në hartimin e projektligjit "Për Kultivimin, grumbullimin, perpunimin, prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij" kanë qenë të përfshirë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, shoqatave, subjekteve që operojnë në fushën e duhanit, etj. Procesi i hartimit të projektakteve u shoqërua nga një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira dhe përfaqësuesve të shoqatave, grupeve të interesit, etj.

##### *2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës ka qenë:

- përfaqësues nga shoqatat që operojnë në fushën e bujqësisë;
- përfaqësues nga Universiteti Bujqësor;
- përfaqësues nga projektet që mbështesin sektorin e bujqësisë;
- përfaqësues institucione të varësisë.

##### *2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit, kanë marrë pjesë për projektaktet e planifikuara për konsultim rreth 43 palë të interesuara, nga të cilët rreth 28 kanë dhënë komente/sugjerime me qëllim përmirësimin e projektligjeve.

*2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Struktura e kontribuesve në konsultimet publike:

- Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Shoqata që operojnë në fushën e bujqësisë;
- Akademikë në fushën vreshtarisë;
- Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- Komisionin Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën;
- Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes vendore;
- Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Shoqata e Sommelierisë Shqiptare: komunikim përmes postës elektronike;
- Enologë të pavarur;
- Institucione të varësisë.


*2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në takimet/komunikimet e zhvilluara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, edhe nga monitorimi i portalit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projektaktet e publikuara në të.

**2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

*2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*


Komentet dhe sugjerimet e marra nga konsultimi nëpërmjet takimeve dhe postës elektronike ka qenë rreth 79 komente/sugjerime. Mesatarja e komenteve të marra për çdo projektakt të konsultuar është rreth 13. Komentet/sugjerimet më të shumta kanë qenë për projektligjin “Për vreshtarinë dhe verën”. Në mënyrë të detajuar për çdo projektligj të konsultuar komentet/sugjerimet paraqiten si më poshtë:




### 2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Rezultojnë 79 komente të mbledhura për 6 aktet e konsultuara gjerësisht me grupet e interesit, prej të cilave:


- 36 janë pranuar plotësisht
- 9 janë pranuar pjesërisht
- 34 janë refuzuar.



Pra, 45.6% e komenteve janë pranuar plotësisht, 11.4% e tyre janë pranuar pjesërisht dhe 43.0% janë refuzuar.



Në mënyrë të detajuar sipas projektligjeve të konsultura me publikun:



### 2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, janë përdorur më shumë metoda konsultimi; jo vetëm konsultimi publik përmes RENJK, por dhe përmes tryezave të konsultimit dhe postës elektronike.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuarnë bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Nuk ka patur ndryshime/përditësime të VNR-së nga informacionet e marra gjatë konsultimit publik.

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për vitin 2020 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka publikuar asnjë raport konsultimi.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Publikimi do të bëhet sipas nenit 20 të ligjit 146/2014. Pas miratimit nga KM, do të publikohet në programin e transparencës dhe në RENJK.

## **2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

Referuar formatit të vetëvlerësimit të indeksit të performancës institucionale për përmbushjen e kërkesave (kriterëve) të përcaktuara në ligjin nr.146/2014, "Për njoftimin dhe Konsultimin Publik", rezultati mesatar i vlerësimit të cilësisë së procesit të konsultimit për vitin 2020, është 7.7

## **3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)**

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.